



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Sociologji e Përkthimit

Ngarkesa në orë/kredite; 40 orë mësimore, 4 kredite 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti II / Semestri I/II

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Me përfundimin e këtij kursi studenti duhet të jetë në gjendje:

të kuptojë dimensionin social dhe politik të përkthyesit dhe të përkthimeve. Të kuptojë rëndësinë e përkthyesve dhe të punës së tyre në shoqëri. Të perceptojë konceptin e identitetit kulturor dhe kombëtar siç pasqyrohet në përkthimet e teksteve letrare dhe kulturore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të kuptojë metodat dhe strategjitë e aplikuara nga përkthyesit në kontekste të veçanta politike dhe sociale
2. Të kuptojë metodat dhe strategjitë e aplikuara nga përkthyesit në mjediset e punës të mediave ndërkombëtare
3. Të kuptojë metodat dhe strategjitë e aplikuara nga përkthyesit në mjediset e punës të organizatave ndërkombëtare
4. Të kuptojë metodat dhe strategjitë e përdorura nga përkthyesit në situata konflikti